



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**LEGJISLATURA IV**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Integrime Evropiane**

**Mbledhja nr. 12**

**Prishtinë, më 21. 06. 2011, në orën 13:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302**

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Lutfi Haziri, Sasha Milosavljeviq, Blerta Deliu - Kodra, Alma Lama, Blerim Shala, Suzana Novobërdali, Vjosa Osmani dhe Albert Kinolli.

**Munguan:** Xhavit Haliti dhe Fatmir Limaj.

**Me ftesë:** Bedri Hamza – ministër i Financave.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Ahtere Loxha – koordinatore, Safet Beqiri – zyrtar për integrime evropiane dhe Pajtim Gashi - praktikant.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Lejla Simili – OSBE, Ganimete Shaqiri – RTV 21, Ganimete Heseti – KDI, Fexhrije Zymberi – News TV, Arban Abrashi dhe Venera Mjekiqi – Kuvendi.

**Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri** – Kryetar i Komisionit.

**R E N D I I D I T Ë S**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Takim me z. Bedri Hamza, ministër i Financave;**
- 4. Të ndryshme.**

**Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

## 1. Miratimi i Rendit të Ditës

*Rendi i Ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua pa asnjë vërejtje.

## 3. Takim me z. Bedri Hamza, ministër i Financave

**Kryetari** – E falënderoi ministrin që iu kishte përgjigjur ftesës. Tha se në kuadër të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës jeni të ftuar sot të raportoni për masat që Qeveria e Kosovës i ka ndërmarrë për qëndrueshmërinë financiare afatgjatë të financave publike, posaçërisht për problemet që kanë dalë nga marrëveshja *Stand By* me FMN-në, që ndërlidhet me vonesën e Ligjit për prokurimin publik dhe për një takim që do të zhvillohet nesër për këto çështje me Zyrën e Kryeministrit dhe me ministren e Integritimit Evropian.

**Bedri Hamza** – E falënderoi Komisionin për ftesën. E njoftoi Komisionin për zhvillimet makrofiskale dhe të indikatorëve të tjerë financiarë për vitin 2010 dhe për periudhën e këtij viti. Ai po ashtu tha se në vitin 2010 ka pasur rritje ekonomike prej 4 %. Shtoi se plani i të hyrave është përmbushur pothuajse qind për qind dhe për herë të parë në Kosovë është ekzekutuar buxheti i Kosovës në masën prej 94%. Vlerësohet se rritja ekonomike për vitin 2011 në përputhje me vlerësimet e FMN-së do të jetë 5.5%. Ndërkohë te target kemi rritje ekonomike prej 7%. Gjithashtu janë marr në konsideratë edhe çështje sociale për vitin 2011, siç janë çështja e pagave, kostot e ligjeve, që priten të vijnë në Kuvend, si Ligji për pensionet, Ligji për kategoritë e dala nga lufta, si dhe Ligji i Punës që tashmë është miratuar dhe është në fuqi. Me këto ligje kemi pasur kujdes të ruhet niveli i shpenzimeve kapitale, që tani janë të planifikuara në vlerë prej 572 milionë eurosh. Deri më 7 qershor kemi të dhëna se të hyrat janë në performancë të mirë dhe ato kryesisht mbledhen dhe administrohen nga Dogana. Deri më tani ato janë 296 milionë. Pra krahasuar me vitin e kaluar ka rritje rreth 18%. Vlera e të hyrave vendore janë prej 108 milionë, pra janë rreth 16% më shumë se periudha e njëjtë e vitit paraprak. Deri në këtë periudhë buxheti është ekzekutuar rreth 30% ose 476 milionë euro. Inkurajues është fakti se deri në këtë periudhë kemi pasur rreth 22% të planit buxhetor të realizuar. Bilanci bankar në fillim të vitit ka qenë 290 milionë, kurse tash është rreth 350 milionë. Pra kemi pasur rritje të parasë së gatshme dhe rritje të likuiditetit për buxhetin e Kosovës. Të gjitha këto të dhëna janë pozitive dhe inkurajuese. Ne duhet të jemi të kujdesshëm, sidomos në pjesën e dytë të vitit, për përmbushjen e planit të të hyrave. E njoftoj Komisionin edhe rreth zhvillimeve dhe relacioneve me FMN-në. Zakonisht këto marrëveshje lidhen me vendet që kanë problem me likuiditet. Kosova nuk ka qenë një rast i tillë. Ky është vlerësim i institucioneve të Kosovës dhe i FMN-së. Janë pritur iniciativa, sidomos për sferën sociale dhe për ligjet që kanë kosto. Është vlerësuar se Kosova ka nevojë për këtë program, sepse ky program e ka kushtëzuar Kosovën me donacione të tjera nga Banka Botërore dhe nga Komisioni Evropian. Kushtet për këtë program kanë qenë: rishikimi i buxhetit të vitit 2010 në harmoni me Marrëveshjen e FMN-së, miratimi i Ligjit për Bankën Qendrore, amendamenti i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësisë. Këto kushte janë plotësuar dhe më 7 korrik të vitit 2010 është nënshkruar kjo Marrëveshje. Marrëveshja ka paraparë që Kosova të ketë 108 milionë euro kredi nga FMN-ja. Në periudhën makrofiskale, pra në periudhën 2010, ka pasur mundësi të bëhet derdhja e mjeteve nga Komisioni Evropian, në shumë prej 150 milionë eurove, si dhe nga Banka Botërore në shumë prej 60 milionë dollarësh.

FMN-ja e ka bërë derdhjen e mjeteve të para, 22 milionë euro kredi, kurse Komisioni Evropian vitin e kaluar i ka derdhur 30 milionë në buxhetin e Kosovës. Kjo Marrëveshje i ka pasur gjashtë rishikime. Rishikimi i radhës është paraparë të bëhet në tetor të vitit 2010. Ka ardhur misioni i FMN-së. Me të është diskutuar dhe thuhet janë penalizuar të gjitha projeksionet e buxhetit për vitin 2010. Dihet se ka ndodhur shpërbërja e institucioneve të Kosovës dhe vendi ka shkuar në zgjedhje të parakohshme. Buxheti nuk ka mundur të procedohet dhe të miratohet në Kuvend. Ky ka qenë një kriter strukturor, që nuk është përmbushur. Kriter i dytë strukturor ka qenë kalimi i Strategjisë së privatizimit të PTK-së në Kuvendin e Kosovës deri me 31.12.2010. Ky kriter nuk është përmbushur si pasojë e mungesës së institucioneve. Rishikimi tjetër ka qenë në janar, që në mungesë të institucioneve përsëri nuk është përmbushur. Pas konstituimit të institucioneve të Kosovës ka ardhur edhe një mision i FMN-së. Me të është diskutuar buxheti i vitit 2011. Ka pasur ndryshime në raport me projeksionet e tetorit. Ato kanë pasur të bëjnë me pjesën e të hyrave, në të cilat i kemi 109 milionë euro më shumë se në Marrëveshjen e tetorit, që janë konsideruar të qëndrueshme. Ka pasur ndryshim te pjesa e shpenzimeve, sepse zgjedhjet, që ishin paraparë për vitin 2011, ishin pjesë e buxhetit të vitit 2011, kurse janë mbajtur në vitin 2010. Po ashtu e kemi pasur zvogëlim të kapitaleve për 30 milionë euro dhe zvogëlim te subvencionet që kryesisht kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike. Shkurtime që kanë ndodhur në pozicionin mallra dhe shërbime e kanë mundur rritjen e pagave, që është rreth 70 milionë euro për një vit. Çështja e pagave me FMN-në ka pasur progres, por nuk ka pasur harmonizim të plotë për rreth 30 milionë euro për pagat. Kemi pasur vizitë në Uashington dhe e kemi arritur marrëveshjen që quhet *Program i monitoruar nga stafi*. Kanë qenë dy parakushte që i kemi plotësuar. Në bazë të tyre e kemi nënshkruar Marrëveshjen. Kjo Marrëveshje është për gjashtë muaj dhe planifikohet t'i ketë dy rishikime. Rishikimi i parë pritet të ndodhë deri në fund të 30 shtatorit, kurse tjetri pritet të ndodhë në fillim të tetorit ose në fund të nëntorit. Nëse ky rishikim është pozitiv, Banka Botërore ka premtuar se do t'i derdhë mjetet e premtuara për këtë vit në buxhetin e Kosovës. Këto janë kritere dhe duhet të jemi të kujdesshëm në projektet që kanë kosto buxhetore. Tri ligje që janë pjesë e përgjegjësisë së Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale: Ligji për pensionet, Ligji për kategoritë e dala nga lufta dhe përfundimi i akteve nënligjore të Ligjit për të burgosurit politikë. Për to nevojitet kosto financiare dhe dihet sa është kostoja e tyre në një periudhë të ardhshme makrofiskale.

**Blerim Shala** – Pasi jeni duke folur për këto ligje, sa është kostoja e tyre?

**Bedri Hamza** – Nuk kemi arritur ende në fazën e vlerësimit të këtyre ligjeve. Është edhe Ligji për sigurime shëndetësore, që ende nuk e ka marrë dritën e gjelbër për të kaluar. Paraprakisht është kërkuar të dihet kostoja financiare e tij. Projekti tjetër është autostrada Prishtinë – Shkup, që ka kosto të madhe dhe rëndësi të veçantë. Për të duhet të diskutohet me institucionet financiare, sepse kërkohet të dihen saktë sa është vlera reale dhe sa mjetet financiare duhen. Kosova e ka borxhin publik më të ulët në rajon, prej 7% të GDP. Rekomandimet e FMN-së janë që Kosova të mos e kalojë nivelin 30%. Pjesë e kësaj Marrëveshjeje është edhe buxheti, që duhet të harmonizohet me FMN-në. Pra, duhet të kemi shumë kujdes kur marrim iniciativa ligjore, që kanë kosto të lartë buxhetore. Kemi pasur takim me 25 ambasadorë dhe me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. Kemi ardhur në përfundim se në vendet dhe në diplomacitë e vendeve të ndryshme të mos ketë prezantime që nuk janë reale.

Tani me FMN-në E kemi një marrëveshje që quhet *Programi i monitorimit nga stafi* për gjashtë muaj me mundësi të aplikimit të një marrëveshje të re.

**Kryetari** – Shprehu interesimin të dinte lidhur me qëndrueshmërinë dhe me sigurinë financiare të institucioneve të Republikës së Kosovës. Pyeti: Çka është ndërmarrë dhe cilat janë afatet që ju i keni paraparë për vlerësimin e riskut buxhetor për Ligjin e kategorive të luftës?

**Alma Lama** – Ky është buxheti më problematik që Kosova e ka pasur deri më tani. E kuptojmë ministrin që për këtë duhet ta bëjë “avokatin e djallit”. Marrëveshja, që ishte pika e vetme pozitive e vitit të kaluar me FMN-në, është anuluar. Kjo Marrëveshje është anuluar për shkaqe që tashmë janë të njohura. Kosova i ka humbur rreth 157 milionë euro nga FMN-ja dhe është vënë në një program monitorimi të fortë. Nëse i përmbushë kriteret, këto mjete do t’i marrë vitin e ardhshëm. Si do të tejkalohet kjo situatë? Theksoi se nga takimet që i ka pasur me zyrtarë të FMN-së dhe me Bankën Botërore është njoftuar se autostrada nuk është mbështetur nga ata, prandaj angazhimi i Kosovës në këtë projekte po na çon në këtë kolaps ekonomik. Gjithashtu në projektbuxhetin e paraqitur në Kuvend është parë se një nga ambiciet e Ministrisë është edhe anëtarësimi në OBT. Kurse duke pasur parasysh gjendjen e Kosovës, pyetja ishte se sa është i favorshëm anëtarësimi në OBT ndërkohë që shteti ka probleme ekonomike, kurse prishja e raporteve me FMN-në këtë vit besoj se nuk ndikuar negativisht në anëtarësimin edhe në organizatat tjera ekonomike.

**Vjosa Osmani** – Kërkoj të konfirmohet nga ministri për atë që thuhet nga ekspertë të ndryshëm se për dallim nga *Stand-by Agreement*, marrëveshja *Staff Monitoring Agreement* nuk ka përfitim financiar dhe se përfitimet që i kemi pasur t’i marrim gjatë vitit 2011 nuk do jetë e mundur t’i marrim për vitin e ardhshëm. U përmend se kjo Marrëveshje e re ka kushte shumë të vështira. Nëse mund na tregoni cilat janë ato kushte, që të bëhen të njohura për Kuvendin, në mënyrë që të mbikëqyren nga Qeveria që të mos rezultojnë me mospërmbushje. Çështje tjetër që na intereson ta dimë janë ligjet që pa koston financiare vijnë në Kuvend. Si shembull për këtë mund të merren Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe Ligji për ndihmë juridike, për të cilët ka pasur rekomandim nga kjo Ministri që të mos miratohen. Thjesht të mos miratohen ligje që do të mbesin në sirtarë. Çështje tjetër është anëtarësimi në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, sepse pas keqësimit të raporteve me FMN-në është krijuar një situatë jo e mirë. Ç’është duke ndërmarrë Ministria dhe si do të kalohet kjo situatë, kur dihet se vetëm dy vota i duhen Kosovës për t’u anëtarësuar në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim?

**Blerta Deliu – Kodra** – Kërkoj të dinte për disa ligje, siç janë Ligji për pensionet, Ligji për kategoritë e dala nga lufta, Ligji për të burgosurit dhe ai për sigurime shëndetësore që e kanë marrë aprovimin për t’u miratuar. Cilat janë ato ligje që do ta marrin dritën e kuqe dhe nuk do të aplikohen për shkak të implikimeve buxhetore?

**Blerim Shala** – Ministria e Financave është një nga ministritë më të rëndësishme, sepse e mban edhe “kuletën” e shtetit. Në ligjin për vitin 2011, që e kemi miratuar dhe që është përgatitur para ndërprerjes së *Stand-by Agreement*, është paraparë që ne ta kemi një deficit buxhetor prej 227 milionë eurosh në fund të vitit. Nga bisedat me FMN-në e dimë se privatizimi i 75% i aseteve të PTK-së është cilësuar si çelës kyç për ruajtjen e stabilitetit makro-financiar. A do të mund ta ruani stabilitetin makro-financiar, duke e ditur se nuk ka *stand agreement* për këtë vit? A mund ta privatizoni PTK-në, siç keni supozuar dhe siç thatë edhe me herët që buxhetin për vitin 2012 duhet ta hartoni dhe ta miratoni në marrëveshje me FMN-në?

**Suzana Novoberdali** – Si kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe për Peticione më lejoni të ju njoftoj se një nga peticionet që e kemi pranuar në

Komision është edhe peticioni nga pensionistët, që janë të pakënaqur me pensionet shumë të ulëta. Kështu, pa dashur të flasim për ligjet, sipas rëndësisë, do të doja të dija përafërsisht nëse dihet kostoja e Ligjit për pensione dhe kur mund të pritët të vijë për miratim në Kuvend. Ju e përmendet edhe Ligjin e punës, që është miratuar. Në çfarë konteksti e përmendët këtë dhe a ka pengesa në zbatim?

**Sasha Milosavljevic** – Tha se Ministria, por edhe Qeveria kanë kapacitete t'i tejkalojnë të gjitha vështirësitë.

**Albert Kniolli** – Pyeti për Planin e Veprimit sa i përket integritetit. Cila është strategjia e zhvillimit të sektorit financiar?

**Bedri Hamza** – Theksoi se Ligji i punës është miratuar nga Kuvendi dhe për herë të parë ka filluar të implementohet. Sipas vlerësimit të Ministrisë së Financave fillimisht është menduar se do të ketë kosto 1.5 milionë euro, mirëpo pas amendamentimit kjo kosto ka arritur në 5.8 milionë euro. Gjithsesi ne e kemi ndarë këtë shumë që është pjesë e buxhetit të vitit 2011. Po ashtu ka vërejtje për Ligjin e punës, sidomos për pushimin e lehonisë. Thuhet se po favorizohen vetëm femrat në sektorin publik. Me zgjatjen e pushimit të lehonisë, duke dashur t'i ndihmojmë kësaj gjinie, realisht po i sjellim pengesa, sepse po e ka të vështirë të gjejë punë në sektorin privat, prandaj edhe rekomandohet të amendamentohet Ligji. Ligjin për pensione e sponsorizon Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale. Brenda një afati ligjor mendojmë ta shqyrtojmë këtë Ligj. Deri më tani kanë ardhur disa drafte dhe në bazë të draftit të fundit do të përgjigjemi për të, si do ta akomodojmë në buxhetin e Kosovës. Ligji për kategoritë e dala nga lufta është në strategjinë e vitit 2011. Shpresojmë se brenda kësaj jave gjithçka do të finalizohet, shumë shpejt do të miratohet në Qeveri dhe do të procedohet për miratim në Kuvend. Sa u përket dy kategorive: kategoria e familjeve të dëshmorëve dhe kategoria e invalidëve të luftës, që aspektin financiar e kanë të rregulluar me vendim të Qeverisë në fillim të këtij viti, ne si Ministri kemi paraparë kosto për këto kategori dhe ato tashmë janë pjesë e tabelave financiare. Çështjes e autostradës është harmonizuar me FMN-në. Po të mos ishte bërë atëherë kjo Marrëveshje, me FMN-në më nuk do të bëhej më. Në vitin 2010 për këtë projekt janë paguar 107 milionë euro dhe buxhetin e kanë miratuar shumica e deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

**Alma Lama** – Kur folëm për FMN-në folëm për aspektin e kredimarrjes. Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtarë realisht nuk janë bërë mbështetës për projektin e autostradës. Ne kemi informacione të sakta dhe të gjithë besoj që i kanë po ashtu, pra para se të merret vendimi për autostradën janë zhvilluar bisedime me këto organizata për të gjetur mënyrën e financimit. Këto informata i kemi marr nga Baka Botërore në Uashington. Siç e dimë zyrtarisht FMN ka rekomanduar që mos të hyhet në këtë projekt, fjala është para se Qeveria të vendosë për të hyrë me buxhet në këtë projekt (projektin e autostradës). Anëtarësimi në FMN ka qenë një nga sukseset që ka marrë shumë energji ndërsa prishja e marrëveshjes e ka dëmtuar imazhin e Kosovës prandaj si është reflektuar kjo sa i përket atyre investitorëve që kanë pasur të vijnë në Kosovë?

**Blerita Deliu - Kodra** – E pyeti ministrin: A është zbehur imazhi i Kosovës te investitorët e jashtëm?

**Blerim Shala** - Sa i përket financimit të rrugës 6 (gjashtë) Qeveria deri vonë e ka spikatur variantin e koncensionimit. Tash a keni hequr dorë nga kjo që të ketë kredi të buta dhe të merren

fonde nga buxheti dhe nga Agjencia e Privatizimit, edhe pse fillimisht duhet ta ndryshoni ligjin për këtë? Për periudhën e zhvillimit ekonomik ju e keni paraparë edhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve se Dogana do të vazhdojë të jetë bartësi kryesor i të hyrave në buxhetin e Kosovës. Sa i përket zhvillimit afatmesëm ekonomik a keni paraparë që në segmentin e integritimit në BE nuk ka të hyra nga Dogana, atëherë si do ta bëni këtë?

**Bedri Hamza** - Theksoi se nuk është kërkuar kredi për këtë projekt që u përmend, sepse është

vlerësuar se Kosova mund ta ndërtojë atë prej kapaciteteve të veta financiare. Komisioni Evropian deklaroi se Kosova gjithmonë, duke supozuar në respektimin e Marrëveshjes, do t'i marrë këto para. Pra, paratë nuk janë të humbura, por duhet të plotësohen kushtet për t'i marrë ato. Ne duhet të kemi kujdes se për çfarë po i marrim këto para: për t'i ruajtur rezervë apo për t'i investuar diku. Dihet, se paratë që merren, futen në nivelin e borxhit publik. Kosova ka deficit buxhetor më të vogël se shumica e vendeve të BE-së. Ajo nuk e kalon shifrën 3%, që ka qenë në kuadër të parametrave të Kopenhagës. Për vitin 2011 është paraparë që deficitin buxhetor të jetë 226 milionë euro, nëse supozojmë se buxheti i Kosovës arrin të shpenzohet 100%. Aktualisht Kosova e ka bilancin bankar rreth 7% GDP-së, apo 350 milionë euro. Sipas FMN-së një prej kritereve që përmendet është edhe gjendja e bilancit bankar, që shikohet tri herë në vit. Sa i përket rrugës së re Prishtinë – Shkup, të gjithë pajtohem se sjell përfitim për Kosovën. Mirëpo nuk do t'ia fillojmë asaj pa i siguruar financat. Si do të financohet është duke u bërë fizibiliteti ku janë të përfshirë FMN-ja dhe USAID-i. Programi i monitorimit nga stafi nuk të jep qasje në kreditë e FMN-së, por e hap rrugën për *Stand by Agreement*. Këtu u përmendën ligjet pa kosto financiare. Unë u lutem deputetëve ta kenë në konsideratë mbulesën financiare. Po ashtu u përmend anëtarësimi në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Do të ishte një interes shumë i madhe për Kosovën, sidomos për zhvillimin e sektorit privat. Jemi optimist se deri në fund të vitit do të përmbyllet suksesshëm ky proces. Ligjet që nuk e kanë dritën e gjelbër, në relacion me FMN-në, janë ato që paraprakisht nuk janë pjesë e kornizës së shpenzimeve afatmesme, që nuk u dihet kostoja financiare ose që kanë kosto të lartë dhe nuk janë në përputhje me rregullat e BE-së dhe me ato të *Acquis Communautaire*. Këtë vit deficitin i planifikuar është 227 milionë. Shpresojmë se në fund të vitit do të jetë më i ulët, meqë nuk shpresoj se do të ekzekutohet buxheti 100%. Vetëm këtë vit kemi planifikuar t'i kemi 170 milionë euro më shumë prej Administratës Tatimore dhe prej Doganave. Buxheti i vitit 2011 gjithsesi do të diskutohet me FMN-në dhe pritet të vijë një delegacion i FMN-së. Pritet që në fund të tetorit, deri në datën 31 ta dërgojmë për miratim buxhetin, ashtu siç edhe e kemi detyrim ligjor. Ne kemi diskutuar me FMN-në dhe jemi pajtuar që këtë vit të fillojmë me emetimin e bonave të thesarit dhe të startohet në fillim të vitit 2012.

Me FMN-në kemi relacione dhe një marrëveshje. Për shkak të zhvillimit ekonomik, sa i përket anëtarësimit të Kosovës në organizatat financiare, është normale të ketë edhe implikime të tjera. Neve nuk na ka konveneruar ndoshta të jemi as anëtarë të CEFTA-s. Nesër ndoshta mund të mos jemi të përgatitur edhe në aspektin e konkurrencës për anëtarësim në BE. Mirëpo, sidoqoftë, duhet të ecim në drejtim të integritimeve dhe duhet të investojmë që t'i përgatisim kompanitë tona të jenë më konkurrense dhe më të përgatitura. Asnjëri nga ne nuk pretendojmë të themi se

gjithçka është në rregull. Kemi thënë se edhe papunësia, edhe varfëria janë në shkallë të lartë. Deficiti tregtar, që ka qenë 43% vitin e kaluar, këtë vit ka rënë në 40%. Bilanci bankar është 7%. Nëse privatizimi i PTK-së përfundon suksesshëm dhe arrihet të përmbushen marrëveshjet me FMN-në dhe me mekanizmat e tjerë, Kosova në periudhën e ardhshme makro-fiskale do të ketë stabilitet. Sa i përket pyetjes së z. Shala, rruga është në fazën e studimit të fizibilitetit dhe të opsioneve. Do të kishe qenë mirë që kjo të ndërtohej jo nga buxheti i Kosovës. Nuk është hequr dorë, por analizat do të tregojnë se si do të ndërtohet rruga. Nuk kam informacione se në Ballkan janë ndërtuar shumë rrugë me partneritetin publiko-privat. Sa u përket doganave dhe ATK-së, është mirë që është potencuar se sa më afër BE-së që të jemi, roli i doganave do të vijë duke u zvogëluar. Kështu vjen duke u zvogëluar roli i të hyrave në kufi në favor të të hyrave në brendi. Edhe ndryshimi i statusit të vendit e imponon një gjë të tillë. Në këtë drejtim do të luajnë rol edhe bizneset, sepse sot janë të obliguara të paguajnë obligimet e tyre për mallrat që ende nuk i kanë shitur. Qëllimi është të ngrihen kapacitete të institucioneve që merren me administrimin e të hyrave në brendi, të reformohen dhe të riorganizohen doganat dhe të zvogëlohen të hyrat në kufi në dobi të të hyrave në brendi. Sa i përket pyetjes për FMN-në, informatat nuk janë zyrtare dhe nuk janë të sakta. Dua t'ju sqaroj se para se ta fusim vendin në ndonjë borxh publik, duhet të ndiqen të gjitha procedurat dhe duhet të kalojnë edhe në Kuvend, me 2/3 e votave të deputetëve. Ndoshta ka pasur biseda, por ato kanë qenë jozyrtare. Zyrtare është se Kosova autostradën Vërmicë - Merdare, të quajtur rruga "Ibrahim Rugova", e ka të planifikuar në buxhet. Unë nuk ju referohem bisedave joformale dhe jozyrtare. Ne kemi nevojë për përkrahje dhe për këtë punojmë me përkushtim. Investitorët e kanë mënyrën e vet të përkushtimit dhe të aplikimit. Ne kemi kompani, sidomos në tregun financiar, shumica e të cilave janë të jashtme. Shembull për këtë i kemi *Ferroniklin*, *Llamkosin*, etj. Është mirë që kanë ardhur dhe duhet të vijnë edhe më shumë kompani. Aktualisht i kemi dy kompani të kualifikuara për ta privatizuar PTK-në, që kanë abonentë rreth 160 milionë dhe 35 miliardë qarkullim. Me disa indikatorë jemi keq e me disa mirë, por jemi të përkushtuar, që mbi të gjitha, bizneset t'i trajtojmë me korrektësi.

**Kryetari** – Edhe një herë e falënderoi ministrin. Theksoi se disiplina financiare është një nga kushtet themelore për integrim evropian. Do t'ju ftojme në periudhën e dytë, të paraparë sipas planit të punës së Komisionit, për ta parë forcimin e masave të Qeverisë. Shpresojmë se masat që do të ndërmerren do ta përballojnë këtë situatë dhe do të evitohet kërcënimi, që në mungesë të disiplinës fiskale, çon drejt shkatërrimit financiar që do të ishte tragjike për të gjithë ne.

## **Të ndryshme**

**Kryetari** – Pohoi për praninë e dy projektligjeve për shqyrtim nga Komisioni dhe për caktimin e raportuesve. I njoftoi anëtarët e Komisionit për dy takime që do të mbahen nga Grupi për Standarde Evropiane të kryesuar nga Alma Lama. Takimet do të bëhen nesër në Qeveri, përkatësisht në Zyrën e Kryeministrit dhe në Ministrinë e Integritimit Evropian.

Mbledhja përfundoi në 14:20

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

Lutfi Haziri